

Zhvillimi në tregun e TI-së në Kosovë

Teknologjia e informacionit (TI) është një nga sektorët më të rëndësishëm në Kosovë. Zhvillimi i këtij sektori është thelbësor për rritjen ekonomike në vend përmes inovacionit, konkurrencës, transformimit dixhital, krijimit të vendeve të reja të punës, tregëtinë, si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Për të kuptuar trendin e zhvillimit në sektorin e TI në Kosovë, kemi zhvilluar një analizë të thellë nga të dhënat e marra nga Administra Tatimore të Kosovës (ATK) dhe Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK).

Të dhënat e mbledhura nga ATK kategorizohen në katër fusha kryesore: deldarimi i aktiviteteve, qarkullimi financiar, pagesa e tatimit dhe deklarimi i punëtorëve dhe mbulojnë periudhën 2019-2022. Kurse të dhënat në ARBK janë vetëm për vitin 2022 dhe ofrojnë pasqyre të përgjithshme të gjendjes së sektorit të TI në bazë të gjinisë, numrit të punëtorëve, numrit të bizneseve, shumës së kapitalit, dhe të komunave.

Fokusi primar i kësaj analize është në të dhënat e ATK-së, të cilat kapin numrin e kompanive aktive dhe të regjistruara në formate të ndryshme organizative, si Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK), Kompanite Individuale, Kompanite e Huaja etj. Për qëllimin e kësaj analize, jemi fokusuar në 9 formate specifike të organizimit të kompanive dhe 8 aktivitete kyçe që janë primare për këto kompani.

Të dhënat analizuar nga:



Mbështetur nga:



Dashboard i dizajnuar nga:



[HYR NË PLATFORMË](#)